

Prof. dr. Valter SHTYLLA

## PORTAT E ARTA TË VIA EGNATIAS NË BALLKAN

Historia e rrugës antike Via Egnatia e meriton të ndriçohet dhe botohet për shumë arsye. Trasimi topografik mjaft komod, kalldrëmet solide, veprat e artit të shumta, si: urat e gurit e drurit, muret mbajtës, kanalizimet etj., formulojnë historinë e teknikës së ndërtimit të saj. Ekspeditat e shumta ushtarake gjatë shekujve të ndryshëm përshkruajnë historinë militare të Via Egnatias. Veç këtyre, kjo rrugë antike ka qenë bartëse e kulturave të ndërsjellta. Ajo lidhte ndërmjet tyre qendra të botës antike, si: Durrachium, Skampin, Lychindin, Heraklean, Edesen Pellen, Tesalonikun, Neapolis (Kavallen) dhe Kostandinopojën, duke qenë kështu një rrugë kulturore e integritit të traditave dhe e komunikimit human. Përveç treguesve të mësipërm, që përbëjnë historinë komplekse të Via Egnatias, kjo rrugë antike tingëllon mjaft interesante në aktualitetin euro-ballkanik. Sot Via Egnatia përfaqësohet nga i ashtuquajtimi "Korridor 8", që aq shumë u përfol në projektide, projekte teknike dhe preventiva dhe nuk është punë e humbur kot. Romakët, që kur e ndërtuan në shekullin II p.e.s., e zgjodhën atë si variantin më të shkurtër dhe ekonomik ndërmjet Durrësit dhe Kostandinopojës, nëpërmjet Selanikut. Duke kaluar një terren të shkurtër malor në malet e Polisit, gjatë luginës së Shkumbinit, në Iliri, dhe qafat e buta në Bukovo e Xhevato në segmentin Lychnid-Heraklea në Maqedoni, nga pikëpamja fizike Via Egnatia përfaqësonte një aks rrugor, i cili, veç lartësive të cituara më sipër, përshkohej në ultësira bregdetare deri në Kostandinopojë. Rrugë e shkurtër, përgjithësisht fushore, dhe që kalon nëpër qytete të rëndësishme të Shqipërisë, Maqedonisë, Greqisë dhe Shqipërisë.

Janë pikërisht këto avantazhet e kësaj rruge etnike që e bëjnë

atë të lakohet aq shumë në opinionet aktuale. Vija historike Egnatia kalonte nëpër katër territoret e mësipërme dhe gjithë rrugët e tjera në veri e jug të saj janë veçse degë të saj. Rigjenerimi i kësaj rruge, me të dy orientimet Maqedoni-Bullgari si dhe Maqedoni-Greqi-Turqi, përbën një faktor jetik për Shqipërinë. Në fazën e shfrytëzimit, Shqipëria është tranzite e vlerave ekonomike-kulturore. Si të thuash, vendi ynë do ta ketë pozitën në mesin e sofrës ballkanike e, në këtë rast, shansi historik është dhe ai duhet shfrytëzuar. Komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërgjegjësohet se, jo rastësisht, Iliria-Shqipëria ka qenë shtrat i Via Egnatias të ndërtuar nga romakët, të cilët janë dalluar për trasime rrugësh apo ndërtime të arrira të çfarëdollojti.

Emergenca të tilla, si faktori ekonomik, investimet e huaja dhe hapja e vendit drejt niveleve të larta të qytetërimit, nuk pranojë zvarritje të problemeve kardinale të zhvillimit. Rrugët gjithmonë kanë shprehur zhvillimin e një vendi. Historikisht, vendi ynë, për vetë pozitën, i ka pasur gjithmonë ato. Sot kemi të drejtën e rigjallërimit të tyre, edhe në ndonjë rast në ballafaqime ekskluzivitetesh prej të tjerëve. Rrugët lidhin popujt, zhvillojnë vendet ku kalojnë, dhe ato duhen hartuar, aq më tepër sot në pretendimet për një Evropë komunitare. Korridori i 8-të (pjesërisht dhe tërësisht Via Egnatia), Rruga Durrës-Prizren dhe ajo me origjinë antike, rruga transversale Veri-Jug, nuk janë veçse shansi i Shqipërisë.

Për ndërtimin e Via Egnatias shprehet një gur miliar i zbuluar në vitin 1974 në rrethinat e Selanikut. Në këtë gur, në latinisht dhe greqisht lexohet emri i prokonsullit të Maqedonisë Knaesus Egnatius, biri i Gaiusit, sunduesit të Romës si dhe distanca prej 260 miljesh ndërmjet Durrachiumit (Durrësit dhe Thesalonikit). Ky shënim, me emrin e shtetarit më të lartë të provincës së Maqedonisë, nën pushtetin e të cilit u ndërtua kjo rrugë, shpreh faktin historik se punimet e Via Egnatias u realizuan në periudhën republikane të Romës, ndërmjet viteve 146-143 p.e.s. Në fillimet e prokonsullit të Egnatiusit në Maqedoni, emrin e të cilit e mori dhe vetë rruga, Via Egnatia në Ballkan ishte vazhdim i Via Apias së njohur të gadishullit Italik të Apenineve, ndërtuar në vitin 312 p.e.s. nga censori Apius Klaudit, i ngarkuar me pasurinë shtetërore dhe me punët publike. Via Apia, nga Roma

zbriste drejt jugut deri në skelën e Brindisium (Brindizi), për t'u hedhur matanë Adriatikut, në Durrachium. Ndërsa Egnatius e ndërtoi këtë aks romak, perandori Trajan (98-170) ndërmori gjatë Egnatias punime të tilla të rëndësishme saqë emri i këtij perandori konfondohet me emrin e krijuesit të rrugës Egnatia. Via Egnatia, si një rrugë antike me vlera të njohura funksionale, përveçse ishte një zgjidhje teknike optimale e pasur me elemente strukturore, ka qenë trajtuar dhe si një vepër monumentale. Në qytetet antike, ku ajo kalonte, ishin të njohura harqet e triumfit me relieve dekorative, si dhe portat madhore.

Nëpërmjet portave, Via Egnatia hynte në sistemet e fortifikuara të qyteteve të asaj kohe. Portat e qyteteve antike, ku kjo rrugë, duke çarë muret e fortifikuara, futej në qytet mes për mes, duke dalë nga faqja simetrik e fortifikimit, quheshin Porta e Artë - Golden Gate. Deri më sot, Golden Gate të Via Egnatias në Ballkan, diku të ruajtura apo diku sipas burimeve, hasen në Durrachion (Durrës), Schampis (Elbasan), Tesalonik (Selaniku) dhe në Kostandinopojë (Stamboll). Gjurmët e Portës së Artë në Kalanë e Durrësit dolën pas prishjes së godinës së ish-Shtëpisë së Pionierit, përballë Interklubit. Ajo ndodhet në murin më të hershëm të Kalasë, traktmuri i shek. III-VII të erës sonë, ndërtuar me tulla. Punimet e çlirimit, të kryera në fundin e vitit 2000, evidentuan konstruksionin e Portës së Artë të Durrësit. Nën asfaltin e rrugës doli gjurma e fillimit të qemerit të madh me tulla në mbështetjen e djathtë të saj. Pas llogaritjeve, ky qemer rezultoi me hapësirë drite rreth 9.6m. Djathtas tij ndodhet qemeri i vogël i kalimit të këmbësorëve me hapësirë drite 2.5m. Qemeri i majtë nuk ruhet, por gjurmët e tij mund të jenë nën lulishten pranë. Porta e Artë e hyrjes së Via Egnatias në Durrachion dhe në vetë Gadishullin Ballkanik ka formë klasike: Një hark i madh qendror për kalimin e qerreve me dy harqe simetrike më të vegjël anash për kalimin e këmbësorëve.

Në dekadën e fundit të shek. XVII, studiuesi Cornelli jap një gravurë të Durrësit ku dallohet hyrja nga deti e qytetit të fortifikuar. Harku i portës ndodhet në pjesën e poshtme të një kulle katrore. Mbi harkun janë hapur dy dritare. Kjo kullë është po ajo që shihet në fotografitë e viteve 1909 e 1914, në botimet

për Durrësin. Mbështetur në krahasimin e niveleve ndërmjet gjurmës së thembrës së qemerit të madh dhe të thembrës së qemerit të hyrjes së pas 1690-ës, është e qartë se pavarësisht se ndodhen në të njëjtin vend, Golden Gate i Via Egnatias nuk është porta e Jallisë e skicës së 1690-ës apo e fotove të fillimit të shekullit XX. Është e qartë se pas shkatërrimeve historike që ka pësuar qyteti i Durrësit, Golden Gate i Via Egnatias është dëmtuar, ndoshta ngaqë për shkaqe të uljes së tokës. Pas dëmtimit të saj, të paktën që prej shek. XVII, në të njëjtin vend të ish-hyrjes monumentale romake, Golden Gate, me të njëjtin model është rindërtuar hyrja e re e qytetit nga ana e detit. Në vazhdim të traditës së Golden Gate, si hyrja klasike e Via Egnatias së famshme, në periudhën turke hyrja nga deti për në qytetin e fortifikuar të Durrësit është quajtur “Porta e Jallisë”, mesa duket në gjuhën shqipe – “Porta e xhadesë (rrugës)”, pasi turqit “Jallu” i thonë rrugës. Kjo dëshmon përsëri për faktin se kemi të bëjmë me portën monumentale të një vije - rruge, të njohur gjatë kohërave.

Portë të Artë të Via Egnatias duhet të ketë pasur në fazën më të hershme të Kalasë së Elbasanit, shekulli IV i erës sonë. Në fortifikimin e Scampias (Elbasani), Via Egnatia hynte në mesin e murit perëndimor pranë muzeut të luftës dhe, pasi përshkonte qytetin, dilte nga lindja. Nga Golden Gate i Scampisit nuk ruhet asgjë në këmbë, përveç fundamenteve arkeologjike të nëndheshme. Siç vërehet nga gjurmët e kullave në daljen e Via Egnatias, në Scampis hyrja e dalja e Via Egnatias kanë pasur një strukturë tjetër, të pakën të gjykuar nga faza mesjetare, pasi sqarimi i fazës antike kërkon gjurmimin arkeologjik. Por ato, me qemerë nga të dy anët, mbroheshin me kulla gjysmë rrethore që dilnin jashtë mureve gjatësore. Qyteti i Selanikut ka qenë një nga qendrat më të rëndësishme ku kalonte Via Egnatia në Ballkan. Bulevardi kryesor i saj mban emrin Via Egnatia. Sipas planimetrisë së fortifikimit, hyrja Golden Gate futej nga muri perëndimor që mbyll dhe aksin e sotëm “Odhos Ignatia”. Në Selanik, në mesin e këtij bulevardi ndodhet Harku i Triumfit i Galerios, nga vendasit i njohur me emrin Kamara, nën të cilin kalonte Via Egnatia. Galerio ka qenë ushtarak i lartë romak me origjinë ilire. Më 1 mars 293, Galerio u bë një nga pjesëtarët e

“Tetrarkisë” (Pushteti i të Katërtëve” i krijuar nga Diokleciani). Galerio nga Iliria në periudhën 293-305 u shpall Cezar dhe, më pas, deri më 311, ai ishte “August - perandor”. Në vitet 297-298 Galerio arriti një fitore të bujshme mbi persianët. Kësaj fitoreje Galerio i kushtoi pikërisht Harkun e Triumfit në qendër të Selanikut. Harku i Galerios është një konstruksion solid me kompozim simetrik – qemer i madh me tulla me hapësirë drite 9.7m - me dy qemerë më të vegjël me hapësira 4.85m. Lartësia e harkut të madh arrin në 12.5m. Në Kamaran e Galerios këmbët e harqeve janë veshur me pllaka guri të bardha, ku janë gdhendur skena interesante nga jeta e këtij perandori romak me origjinë ilire, përfshirë dhe skenën e fitores së tij me persët.

Së fundi, pasi përshkoi gjithë Ballkanin, Via Egnatia arrin në Kostandinopojë (Stamboll) duke hyrë në qytetin e fortifikuar nëpërmjet Golden Gate të njohur në Jedikulen e Stambollit. Jedikule është një citadelë e vogël në formë trapezi të çrregullt me shtatë kulla në muret perimetrave, prandaj quhet edhe “Jedikule” (Shtatë kullat). Ndërtuar në vitet 1457-58 nga Sulltan Mehmeti II Fatih, Jedikule përfaqëson një shembull të arkitekturës ushtarake osmane të shekullit XV. Gjatë këtij ndërtimi, Golden Gate është përfshirë brenda tij. Porta e Artë është një hark triumfi i ndërtuar në vitin 390 nga perandori Teodosius I. Gjatë sundimit të perandorit Teodosius II, në vitet 408-450, u ndërtua muri rrethues i Kostandinopojës, i cili, në sistemin difensiv të tij, përfshiu dhe Portën e Artë. Në qendër të kompozimit të kësaj Porte ndodhet Harku i Madh, i punuar me blloqe guri të gdhendur me finesë, me hapësirë drite 7.75m, anash të cilit janë dy harqet e vegjël me hapësirën 5.7m. Pas hyrjes, duken qartë gjurmët e kalldrëmit të Via Egnatias punuar me gurë të mëdhenj plloçakë të lëmuar sipër. Portat e arta (Golden Gates) të Via Egnatias në Ballkan e kategorizojnë këtë aks antik si një rrugë perandorake në antikitet dhe si një arterie mbretërore në mesjetë, kur, për arsye të luftërave dhe pushtimeve të ndryshme, ajo e humbi disi rëndësinë e saj, bile hera-herë edhe u pezullua.

Për historinë e Via Egnatias është shkruar dhe folur shumë, në kushtet e sotme të krijimit të shumë organizmave kulturore e kombëtare e ndërkombëtare. Kjo vijë antike meriton statusë të

veçanta si Pasuri e Kulturës Botërore, Itinerar Kulturor Ballkanik etj. Evidentimi i elementeve të kësaj vije antike si dhe qendrave dhe objekteve monumentale përgjatë saj përbëjnë një tematikë që duhet trajtuar, pasi, përveç vlerave historiko-dokumentare, ato janë të lidhura organikisht me turizmin kulturor, të cilin ende nuk po e ndiejmë në masën e duhur.